VENDIM
Nr. 204, datë 27.9.2024

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË "KOKA & ERGI ENERGY STAVEC" SHPK, PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "STAVEC"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1765/18 prot., datë 25.9.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi kërkesën e shoqërisë 'Koka & Ergi Energy Stavec' sh.p.k. për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC 'Stavec'",

konstatoi se:

- Shoqëria "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k., e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Stavec", me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1765 prot., datë 15.8.2024 dhe nr. 1765/1 prot., datë 19.8.2024, paraqiti kërkesën dhe dokumentacionin për modifikimin e kësaj licence për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC "Stavec", nga 6,520 mw në 8,46 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 173, datë 29.8.2024, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e kësaj licence, për rritjen e kapacitetit të instaluar të këtij HEC-i nga 6,520 mw në 8,44 mw, duke iu referuar kapacitetit të instaluar që rezulton në Raportin e Oponencës Teknike të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 31.8.2024 dhe 2.9.2024). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE ka njoftuar shoqërinë "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k. për vendimin e Bordit nr. 173/2024 nëpërmjet shkresës nr. 1765/4 prot., datë 29.8.2024, duke evidentuar dhe dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Brenda afatit 10-ditor të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga palët e treta, shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" (FTL) sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/8 prot., datë 6.9.2024, ka bërë me dije se është njohur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173/2024, nëpërmjet njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe informon se në kontratën shtesë koncesionare nr. 675 prot., nr. 224 kol., datë 6.7.2017, kapaciteti i instaluar i HEC "Stavec" është 6520 kw dhe se pranë "FTL" sh.a. nuk është depozituar kontratë shtesë koncesioni për ndryshimin e kapacitetit të instaluar të HEC "Stavec".

- ERE i është drejtuar shoqërisë "FTL" sh.a., me shkresën nr. 1765/10 prot., datë 13.9.2024, duke i sqaruar, ndër të tjera, se: dokumentacioni i kërkuar nga "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe në rastin konkret qëndrimi i MIE-s, apo kontrata shtesë e nënshkruar me të për modifikimin e kapacitetit të instaluar të HEC "Stavec", duhet të depozitohen pranë ERE-s, që është dhe organi i vetëm kompetent për të marrë vendim për modifikimin e licencës. Po ashtu, shoqërisë i është sqaruar, se pas marrjes së këtij miratimi, i licencuari paraqitet pranë FTL sh.a. me dokumentacionin e kërkuar për të bërë ndryshimet përkatëse në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike, i cili është i

vetmi dokument që FTL sh.a. ka tagër për të firmosur, në bazë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve apo të komenteve nga palët e treta (data 9.9.2024), nuk ka rezultuar të ketë të tjera.

- Për sa i përket dokumentacionit që rezulton i paplotësuar nga ky aplikim, rezulton si vijon:

- Në lidhje me qëndrimin apo miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Nga ana e shoqërisë është depozituar vetëm Raporti i Oponencës Teknike për projektin e zbatimit të ndryshuar të HEC "Stavec", dërguar në MIE, me shkresën e AKB-së nr. 1408/2 prot., datë 15.5.2023, nga shqyrtimi i të cilit grupi i oponencës teknike ka arritur në përfundimin se ndryshimet e argumentuara në këtë projekt zbatimi plotësojnë kushtet dhe standardet teknike të projektimit për fazën e zbatimit dhe rekomandon që të pasqyrohen në kontratën shtesë si ndryshime përkatëse, si ato teknike, ashtu edhe ato energjetike.

- Nga ana e MIE-s nuk rezulton që të jetë depozituar ndonjë shkresë vijuese për njoftimin e bërë nga ana e ERE-s për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k.

Nga ana e shoqërisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/14 prot., datë 17.9.2024, bëhet me dije se ajo i është drejtuar MIE-s me shkresën nr. 13 prot., datë 7.7.2023, duke i kërkuar miratimin e projektit të zbatimit të ndryshuar, sikurse përcaktohet dhe në Raportin e Oponencës Teknike dhe njofton se është akoma në pritje të marrjes së miratimit nga MIE.

Për sa më lart, rezulton se shoqëria nuk është pajisur ende me miratimin, apo qëndrimin e MIE-s, sikurse kërkohet nga rregullorja në rastet e modifikimit të një licence.

- Në lidhje me lejen e përdorimit të burimit ujor, me shkresën nr. 1765/5 prot., datë 6.9.2024, ERE i është drejtuar Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), për dijeni shoqërisë, duke kërkuar qëndrimin apo miratimin e saj, në rast se leja për përdorimin e burimit ujor me nr. 27 prot, datë 7.11.2022, për prodhim hidroenergjie nga HEC "Stavec", vlen dhe për projektin e ri të zbatimit të HEC "Stavec", pra për kapacitetin 8,44 mw, apo shoqëria duhet të pajiset me një leje të re për përdorimin e burimit ujor.

Pas korrespondencës përkatëse të zhvilluar me AMBU-në dhe argumentimit teknik të dhënë nga shoqëria, ku ndër të tjera bën me dije se kemi të bëjmë të njëjtin projekt dhe jo me një projekt të ri, dhe si rrjedhojë, nuk kemi të bëjmë me ndryshim të skemës së marrjes dhe të përdorimit të ujit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/17 prot., datë 24.9.2024, AMBU-ja i drejtohet shoqërisë si vijon: "... pavarësisht se sqaroni se nuk do të ketë ndryshim të skemës së marrjes dhe të përdorimit dhe nuk do të ketë ndryshim në mjedis (duke nënkuptuar se nuk cenohet rrjedha ekologjike), ndryshim-rritja e sasisë së ujit në përdorim, kundrejt sasisë së lejuar, sipas lejes që disponon, përbën kusht për subjektin, që të aplikojë për pajisje me leje të re për përdorimin e burimit ujor, referuar kjo përcaktimeve të VKM-së nr. 550, datë 15.7.2020.

Për gjithë sa më sipër përcaktuar nga AMBU-ja, i cili është dhe organi përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore, subjekti duhet të pajiset me leje të re të përdorimit të burimit ujor.

- Në lidhje me lejen e mjedisit, me shkresën nr. 1765/6 prot., datë 6.9.2024, ERE i është drejtuar Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), për dijeni shoqërisë, duke i kërkuar informacion në rast se leja mjedisore e datës 10.7.2013, lëshuar nga AKM-ja për shoqërinë "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k., vlen dhe për ndryshimin e kapacitetit të instaluar të HEC "Stavec", apo shoqëria duhet të pajiset me një leje të re.

Në lidhje me sa më sipër, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/12 prot., datë 17.9.2024, në të cilën është vënë në dijeni dhe AKM, shoqëria bën me dije se HEC "Stavec" ka mbaruar fazën ndërtimore dhe është në fazën e operimi që nga viti 2021, duke shtuar se, me përmirësimin e projektit, është arritur të shfrytëzohet përafërsisht 50% më pak e sipërfaqes totale që ishte parashikuar dhe kjo

është në të mirë të mjedisit. Si rrjedhojë nuk ka qenë e nevojshme të rishikohet leja mjedisore apo VNM-ja.

Në përgjigje të shkresës së ERE-s, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/16 prot., datë 19.9.2024, AKM-ja ka njoftuar, ndër të tjera, se afati i vlefshmërisë së vendimit ka qenë deri më 8.9.2019, duke referuar dhe procedurat përkatëse për aplikim.

Për sa argumentohet nga shoqëria, nuk rezulton që të jetë depozituar ndonjë qëndrim vijues i AKM-së, në rast se leja vlen dhe për projektin e ri apo i licencuari duhet të aplikojë për leje të re, ndaj nevojitet një korrespondencë vijuese me shoqërinë dhe AKM-në.

- Në lidhje me miratimin e operatorit të rrjetit, me shkresën nr. 1765/7 prot., datë 6.9.2024, ERE i është drejtuar "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" (OSSH) sh.a., duke i kërkuar informacion në rast se shoqëria ka depozituar pranë OSSH sh.a. kërkesën për miratimin e shtesës së kapacitetit të instaluar dhe nëse po, cili është statusi i saj.

Nga ana e OSSH sh.a. nuk ka pasur kthim përgjigjeje, ndërsa shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1765/14 prot., datë 17.9.2024, bën me dije se i është drejtuar OSSH sh.a., me shkresën nr. 18/1 prot., datë 9.9.2024, dhe se është në pritje të miratimit përkatës për shtimin e kapacitetit të HEC Stavec në 8,44 mw.

- Në nenin 14, pika 3, të Rregullores, parashikohet, se: Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për sa më lart, me qëllim marrjen e një përgjigjeje/qëndrimi të mundshëm nga MIE dhe OSSH sh.a., si dhe për të zhvilluar korrespondencën përkatëse me shoqërinë, për sa përcaktohet në shkresat e AKM-së dhe të AMBU-së, në mënyrë që në vendimin përfundimtar të Bordit të ERE-s të përfshihet dhe informacioni/dokumentacioni i përditësuar nga shoqëria për sa më sipër, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e kërkesës së shoqërisë për modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC "Stavec".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimmarrjen e Bordit mbi kërkesën e shoqërisë "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Stavec", dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 176, datë 4.11.2020, për rritjen e kapacitetit të instaluar të HEC "Stavec" nga 6,520 mw në 8,44 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë "Koka & Ergi Energy Stavec" sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti